

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21,22 & 44, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPHI-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, të aplikuesve Naim, Blerim dhe Lulzim Kallaba, Rr. Endrit Cara Suharekë, për caktimin e kushteve ndërtimore ndërtimin e ndërtesës individuale banimore/shtëpi/dyshe në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 15.12.2023, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore aplikuesve Naim, Blerim dhe Lulzim Kallaba, sipas kërkesës 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës individuale banimore shtëpi/dyshe, me etazhitet B+P+2, në kuadër të parcelës ndërtimore “L-57-5 dhe L-57-6,7”, të bllokut urban “L57”, të tërësisë hapësinore “L”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr.220-32 dhe 220-33 ZK Çagllavicë.

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të: Planit Rregullues Prishtina e Re – Zona Perëndim, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-186850 dt. 02.10.2013, dhe kjo zonë sipas Informim nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është e planifikuar me “destinim rezidencial-banim individual”;

Gjendja ekzistuese e lokacionit-parcela kadastrale e trajtuar, sipas gjendjes faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - Nr.220-32, ZK Çagllavicë;.....S=572m²; Naim, Blerim dhe Lulzim Kallaba” Arë e klasës 4”;
 - Nr.220-33, ZK Çagllavicë;.....S=413m²; Naim, Blerim dhe Lulzim Kallaba” Arë e klasës 4”;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe çertifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelës kadastrale të lartcekur, bazuar edhe në incizimin gjeodezik, nuk ka ndërtime ekzistuese;
- Terreni është i pjerrët, me disnivel ~0.90 m, nga veri-jug në drejtim lindje -perëndim;
- Qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartcekur, bëhet nga parcela e cila është rrugë egzistuese “Kongresi i Drejtshkrimit”, si dhe me Planin Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, është rrugë e Planifikuar;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale të banimit

III. Kushtet ndërtimore për rregullimin dhe realizimin e dokumentacionit ndërtimor - projektin ideor, të objektit janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në dispozitën urbanistike, e cila i është bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e Kushteve ndërtimore;
- Pjesa e parcelës e trajtuarë me sipërfaqe brenda vijës rregulluese - parcelës ndërtimore, për realizimin e ndërtesës individuale banimore/shtëpive familjare, sipërfaqja e cila është brenda vijës rregulluese gjegjësisht në kuadër të parcelës ndërtimore “L-57-5 dhe L-57-6-7”, të bllokut urban L-57, të tërësisë hapësirë “L”, në kuadër të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, në Prishtinë, është:
 - Nr.220-32, ZK Çagllavicë;.....S=572m²;
 - Nr.220-33, ZK Çagllavicë;.....S=413m²;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelave kadastrale planifikohet ndërtimi i shtëpive individuale të banimit, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje, etazhitet dhe kriteret tjera normative-ligjore, sipas llogarive dhe projekt propozimit, si në vijim:
Ndërtesa individuale banimore / shtëpi /dyshe; parcelat 200/33 dhe 220-32:
 $S=450.00 \text{ m}^2 / 450+450+=900 \text{ m}^2$, mbi tokë dhe $S=259.69+259.69=519.38 \text{ m}^2$;
 Etazhitet: B+P+2;
- Etazhiteti i lejuar sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re - Zona Perëndim”, të jetë max.P+2, Sipas projekt propozimit dhe i miratuar B+P+2;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e shputës së ndërtesës, sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, është max.40%:
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=865.64 \times 0.4=346.25 \text{ m}^2$ / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
 $S=150+150=300 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit; shtëpi dyshe;
- Bazuar në kriteret e PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, koeficienti ndërtimor është i përcaktuar me sipërfaqe ndërtimore max.450 m², dhe ajo sipërfaqe ndërtimore do të llogaritet si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën $\pm 0.00, 50\%$, për etazhet me vëllim mbi **51%** mbi tokë- suteran dhe **0%** për etazhet e nëntokës-bodrumet;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore të parcelës (ISPN) të jetë max.450 m²;
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=450.0 \text{ m}^2$ / maksimale sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
 $S=450+450=900 \text{ m}^2$ mbi tokë / sipas projekt propozimit;
- Koeficienti maksimal i shfrytëzimit të parcelës nëntokësore (ISHPN), për vendosjen e shtëpisë në bazë-gabarit të bodrumit është max.60%, bazuar në Planin Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim”, dhe kjo sipërfaqe do të jetë:
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=865.64 \times 0.6=519.38 \text{ m}^2$ / sipas PRR “Prishtina e Re – Zona Perëndim”,
 $S=259.69+259.69=519.38 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit; shtëpi dyshe;
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISG), sipas pikës 2, paragrafi II. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës 01-031-185481 dt.14.08.2015, sipërfaqja e gjelbëruar e parcelës, e përcaktuar në bazë të Indeksit të Sipërfaqes së Gjelbëruar, duhet të jetë së paku 40%, përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, kjo sipërfaqe mund të jetë së paku 30%:
Ndërtesë individuale banimore / shtëpi familjare:
 $S=865.78 \times 0.4=346.25 \text{ m}^2$ / sipas Vendimit të Kryetarit/
 $S=200+200=400 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr.031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;

- Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga e planifikuar;
- Distanca minimale e objektit nga bordura e rrugës, të jetë:
 - Sipas PRR "Prishtina e Re – Zona Perëndim", të respektohet Vija Ndërtimore e planit;
- Distanca më e vogël nga parcela fqinje te banimi individual është 3.0m. Terasat , shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat etj. nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0m nga parcela fqinje, sipas Planit Rregullues;
- Arkitektura- dukja e jashtme (fasadat) e ndërtesës dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore, me masa të efijencës së energjisë, të qëndrueshme dhe duhet t'i përshtatet ndërtesave të rrethinës;
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vendpакrim, për njësi;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve nuk duhet të dal jashtë parcelës ndërtimore.
- Të bëhet aplikimi i të gjitha kriterëve, normave dhe standardeve urbane, të planifikimit dhe arkitektonike të përcaktuara nga PRR "Prishtina e Re – Zona Perëndim".

IV. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të ndërtesës (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

V. Dokumentacioni ndërtimor-projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ Kosova REF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";

- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;

VI. Ndarja/parcelimi, i parcelës kadastrale nr.220-33 dhe 220-32, ZK Çagllavicë, do të realizohet sipas vijës rregulluese të Planit Rregullues “Prishtina e Re –Zona Perëndim”, në Prishtinë, të paraqitur në dispozitën urbanistike me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore, punuar nga gjeodeti i kësaj Drejtorie. Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit -“Situacioni i ngushtë”, si dhe dispozitës urbanistike me koordinatat e vijës rregulluese të Planit Rregullues në fjalë. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes së parcelës të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të aplikuesit, duke u bazuar edhe në Plani i situacionit - “Situacioni i ngushtë”, si dhe dispozitës urbanistike të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe manualin e ndarjes së parcelës, punuar nga gjeodeti i licencuar nr.75, “GEO DEM” SH.P.K;

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.220-32 dhe 220.33, ZK. Çagllavicë, që trajtohet me këto kushte ndërtimore, në bazë të certifikates së njësisë kadastrale, dhe të përshkruara në pikën 1 të paragrafit III. të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit “arë e klasës 4”, kërkohej që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11,13 dhe 14 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8,9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqën që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore të përcaktuara sipas Plani i situacionit –“Situacioni i ngushtë”, dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelave ndërtimore;

Kjo sipërfaqe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuarit/ve (bashkëpronarëve të parcelës dhe investitorit);

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01– 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor - projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPHI-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Aplikuesit Naim, Blerim dhe Lulzim Kallaba, sipas kërkesë 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë individuale banimore/shtëpi/dyshe, me etazhitet B+P+2, në lokacionin e përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, 05nr.350/07-97789/23 dt.16.05.2023, konstatoi se është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni i mëposhtëm

- *Certifikata e njësisë kadastrale, P-71914075-00220-32, ZK Çagllavicë, dhe kopjen e planit të njësisë kadastrale 220-32, ZK Çagllavicë;*
- *Certifikata e njësisë kadastrale, P-71914075-00220-33, ZK Çagllavicë, dhe kopjen e planit të njësisë kadastrale 220-33, ZK Çagllavicë;*
- *Vërtetimin mbi obligimet tatimore, në emër të Naim Kallaba, nr.10-430/03-0048891/23 dt.07.03.2023;*
- *Informim nga plani rregullues me nr.04-350/01-237492 dt.31.10.02022;*
- *Pëlqim nga pronari Bajram Gashani për tu paisur me leje ndërtimore pronarët Naim, Lulzim dhe Blerim Kallaba, LRP 2756/2023 DT.15.05.2023;*
- *Akti noterial “Pëlqim”, Meritë Demaku me numër P-71914075-00230-31 z.k.Çagllavicë jep pëlqim për ndërtimin e shtëpive në parcelat e lartshënuara sipas kushteve të përcaktuara në planin kadastral të Komunës së Prishtinës të përpiluar te noterja Merita Kostanica, në Prishtinë, LRP.Nr. 2741/2023, dt.15.05.2023;*
- *Akti noterial “Pëlqim”, Bajram Gashani me numër P-71914075-00222-12 z.k.Çagllavicë jep pëlqim për ndërtimin e shtëpive në parcelat e lartshënuara sipas kushteve të përcaktuara në planin kadastral të Komunës së Prishtinës të përpiluar te noterja Merita Kostanica, në Prishtinë, LRP.Nr.2756/2023, dt.15.05.2023;*
- *Akti noterial “Pëlqim”, Bajram Gashani me numër P-71914075-00222-12 z.k.Çagllavicë jep pëlqim për ndërtimin e shtëpive në parcelat e lartshënuara sipas kushteve të përcaktuara në planin kadastral të Komunës së Prishtinës të përpiluar te Noterja Merita Kostanica, në Prishtinë, LRP.Nr.2756/2023, dt.15.05.2023, plotësim dokumentacionit me nr.05-350/02-146988/23 dt.17.07.2023, manualin e ndarjes së parcelës, punuar nga gjeodeti i licencuar nr.75, “GEO DEM” SH.P.K, parcela me nr.200-33, me S=70.00M² dhe parcela me nr.200-32 me S=48.00m², dhe me plotësim 05-350/02-97789/23 dt.16.05.2023, Pëlqim nga pronari Bajram Gashani për tu paisur me leje ndërtimore pronarët Naim, Lulzim dhe Blerim Kallaba, LRP 2756/2023 DT.15.05.2023;*
- *Manuali gjeodezik “Propozim për ndarje sipas Planit Rregullues Urban-Prishtina e Re- Zona Perëndim” për parcelën kadastrale nr.220-32 dhe 220-33 ZK Çagllavicë, i punuar nga gjeodeti i licencuar GEO DEM”, me numër të licencës 75, me dt.e rlevimit: 25.10.2027;*

- Projektin ideor të punuar nga kompania "Shpëtim Berisha Architect", me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.70676044 dt.25.06.2010;
- Kopje e dokumentit të identifikimit të pronarit Naim Kllaba;
- Kopje e dokumentit të identifikimit të pronarit Blerim Kallaba;
- Kopje e dokumentit të identifikimit të pronarit Lulzim Kallaba;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit, në procedurën e shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, dhe plotësim dokumentacionit me nr.05 nr.350/07-97789/23 dt.16.05.2023, Akti noterial "Pëlqim", Meritë Demaku me numër P-71914075-00230-31 z.k.Çagllavicë jep pëlqim për ndërtimin e shtëpive në parcelat e lartshënuara sipas kushteve të përcaktuara në planin kadastral të Komunës së Prishtinës të përpiluar te noterja Merita Kostanica, në Prishtinë, LRP.Nr. 2741/2023, dt.15.05.2023, si dhe dokumentacionit dhe provave të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni- Plani Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", rregullativën ligjore nga lëmi i ndërtimit, planifikimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe konsultimin e projekt propozimit-Projektit konceptual të ndërtesës Plani i situacionit -"Situacioni i ngushtë", të prezantuar, në mënyrë kronologjike ka konstatuar se:

Kjo drejtori pas pranimit të kërkesës, shqyrtimit të sajë me dokumentacionin e prezantuar, dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për ndërtim Nr.04/L -110 dhe Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr.06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosë shkresën "Njoftim publik" për njoftimin dhe mundësin e dhënien së komenteve të pronarëve dhe poseduesve të rrethinës në diametrin e dritës prej 50m' nga parcela ku synohet të ndërtohet, i cili njoftim ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë, nga data.26.05.2023 deri me datë 30.05.2023, gjatë së cilës periudhë nuk kanë arritur komente në E-mail në adresën e vendosura në njoftimin publik;

Sipas projekt propozimit të prezantuar, në kuadër të parcelë kadastrale nr.220-32 dhe 220.33, ZK Çagllavicë, është planifikuar të ndërtohen ndërtesa individuale banimore / shtëpi familjare dyshe, me etazhitet B+P+2, sipas parametrave dhe kriterëve të përcaktuara në Planin Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim" dhe normat e planifikimit; Në bazë të projektit propozimit të prezantuar, qasja ekzistuese e parcelës kadastrale të lartëcekur, e cila me Planin Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim", është rrugë e Planifikuar;

Andaj si konkludim përfundimtar, pas konstatimeve të lartë shënuara, dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni (Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Perëndim"), rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", është prezantuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm dhe projekt propozimi, Projekti konceptual me "situacioni i ngushtë", është në harmoni me destinimin dhe kriteret e Planit Zhvillimor Komunal në Prishtinë për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore

Shtojcë: Plani i situacionit -"Situacioni i ngushtë", me vijën ndërtimore dhe vijën rregullues, dhe Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregullues nga Plani Rregullues ne sistemin koordinativ KOSOVAREF01;


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror– MMPH-së, Departamenti Ligjor i MMPH-së.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/ve, në dosje të 05 nr.350/02-48926/23 dt.07.03.2023, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me Qytetarë.

Përmes postës elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr.350/02-48926/23 DT.15.12.2023**

Zyrtari,
Gëzim Ferizi



Udhëheqëse e Sektorit






Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE
RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN
KOORDINATIV KOSOVAREF01



Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi:

Prishtinë: 31.07.2023

Legjenda:

- Riparcelimi sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcele Kadastrale

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



L-57-10


L-57-9

L-57-8

L-57-7

L-57-6

L-56-5



L-57-3
L-57-4

L-56-3

L-56-5

L-56-7

L-56-9

L-56-8

L-56-11

L-56-10

L-56-12

L-56-14

SIPERFAQET E KALKULUAR PER TE DY OBJEKTET
NE KUADER TE DY PARCELAVE

- ISHP - indeksi i shfrytezimit te parceles 0.4 (40%)
- ISPN- indeksi i sip. pergjithshme nderimore Max 450 m2
- ISGJ - indeksi i siperfaqes se gjelbrimit 25%
- Etagjet e Max P+2
- ISHN- indeksi i shfrytezimit te nentokes 60%

PARCELA 00200-32 DHE PARCELA 00200-32

SIPERFAQJA E PARCELAVE 1000 M2

- SIPERFAQJA E GJELBRIMIT =400M2
- PARKINGU =25.79 M2
- PARTERI = 216.03M2

-GABARITI I OBJEKTIT 300 M2

SIPERFAQJA MBITOKE
TOTALI 898.66 M2

-SIPERFAQJA E PERDHESES 300 M2

-SIPERFAQJA E KATIT 1 300 M2


-SIPERFAQJA E KATIT 2 300 M2

SIPERFAQJA NENTOKE
TOTALI 898.66 M2

-SIPERFAQJA E BODRUMIT 898.66 M2

5
VIJA NDERTIMORE
VIJA RREGULLATIVE
R R U G A

SHËPËTIM BERISHA ARCHITECT	
LOKACION	PRISHTINE
PROJEKTI	IDEOR
SITUACIONE I GJERE	
Projektoi: ing.dipl.arch. Shpëtim Berisha	
Përpunimi teknik: ing.dipl.arch. Shpëtim Berisha	
Klienti: NAIM DHE BLERIM KALLABA	
Shkalla e përpjesës P = 1:75	
SHËPËTIM BERISHA ARCHITECT SH.P.K. PRISHTINE	



VIJA RREGULLATIVE

**SIPERFAQET E KALKULUAR PER TE DY OBJEKTET
NE KUADER TE DY PARCELAVE**

-ISHP - indeksi i shfrytezimit te parceles 0.4 (40%)
-ISPNI - indeksi i sip. pergjithshme ndertimore Max 450 m2
-ISGJ - indeksi i sipërfaqes se gjelbrimit 25%
-Etazhitelet Max P+2
-ISHN - indeksi i shfrytezimit te rrethokës 60%

PARCELA 00200-32 DHE PARCELA 00200-32

SIPERFAQJA E PARCELAVE 1000 M2

-SIPERFAQJA E GJELBRIMIT =400M2
-PARKINGU =25.79 M2
-PARTERI = 216.03M2

-GABARITI I OBJEKTIT 300 M2

SIPERFAQJA MBITOKE
TOTALI 898.66 M2

-SIPERFAQJA E PERDHESES 300 M2

-SIPERFAQJA E KATIT 1 300 M2

-SIPERFAQJA E KATIT 2 300 M2

SIPERFAQJA NENTOKE
TOTALI 898.66 M2

-SIPERFAQJA E BODRUMIT 898.66 M2

0. Ground Floor (3) 1:100

VIJA NDERTIMORE

VIJA RREGULLATIVE
R R U G A

SHITEPLOTESHE
LOKACION
PRIRITJE
KODI
PROJEKTI IDEOR
SITUACIONI I NGUSHTË
Projektoi: ing.dipl.arch. Shpëtim Berisha
Përpunimi teknik: ing.dipl.arch. Shpëtim Berisha
KLIENTI: NAIM DHE BLERIM KALLABA Shkalla e përpjesës A=1:25
SHPETIM BERISHA ARCHITECT SH.P.K. PRISHTINE